



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.02.2023

MBLEDHJA Nr. 08,
Datë 20.02.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 20.02.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 08 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së AAES për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr.23, datë 14.02.2022
2. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1” me kapacitet të instaluar 370 kW dhe “Shutri 2” me kapacitet 1600 kW, me kapacitet total të instaluar 1970 kW
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
6. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI